

Në përputhje me nenin 12, paragrafi 3 i Ligjit për Arsimin dhe Trajnimin Profesional ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 3/25 dhe 74/25), Ministri i Arsimit dhe Shkencës përcatoi

RREGULLORE
PËR MËNYRËN E ORGANIZIMIT TË GARËS PËR NXËNËSIN MË TË MIRË NË SEKTORIN E
VITEVE PËRFUNDIMTARE TË ARSIMIT NË ARSIMIN PROFESIONAL

I. Dispozita të përgjithshme

Neni 1

Me këtë rregullore përcaktohet mënyra e organizimit të garës për nxënësin më të mirë në sektorin e viteve përfundimtare të arsimit në arsimin profesional.

Neni 2

Gara organizohet përmes aktiviteteve përmes të cilave shfaqen, vërtetohen, vlerësohen dhe rangohen njohuritë, aftësitë, shkathtësitë, kapacitetet dhe vlerat (kompetencat) e nxënësve në lëndët profesionale dhe të mësuarit përmes punës te punëdhënësi/mësimin praktik, brenda sektorit/kualifikimit arsimor, në përputhje me kompetencat e përcaktuara në standardet e profesionit për kualifikimin arsimor.

Neni 3

Ministria e Arsimit dhe Shkencës (në tekstin e mëtejshëm: Ministria), në bashkëpunim me Qendrën për Zhvillimin e Arsimit Profesional (në tekstin e mëtejshëm: Qendra), organizon gara për nxënësin më të mirë në sektorin e viteve përfundimtare të arsimit profesional.

Neni 4

Gara zhvillohet individualisht për secilën kualifikim arsimor, ndërsa nxënësi më i mirë zgjidhet në nivel sektori sipas rezultateve të përgjithshme.

Gara realizohet në gjuhën në të cilën nxënësi ndjek mësimin.

Neni 5

Dispozitat e kësaj rregulloreje zbatohen dhe vlejnë njësoj për të gjithë pjesëmarrësit – nxënësit, mentorët, organizatorët dhe komisionet – gjatë realizimit të garave nga neni 1 i kësaj rregulloreje.

II. Mënyrat e pjesëmarrjes në garë

Neni 6

Në garë mund të marrin pjesë të gjithë nxënësit e rregullt nga vitet përfundimtare të arsimit, përkatësisht nxënësit e vitit të katërt në arsimin profesional katërvjeçar dhe nxënësit e

vitit të tretë në arsimin profesional trevjeçar, të cilët do të paraqiten vullnetarisht në thirrjen e shpallur nga shkolla.

Neni 7

Në garat për zgjedhjen e nxënësit më të mirë në sektor, mund të marrin pjesë nxënësit nga kualifikimet arsimore të cilët janë të përfaqësuar në dy ose më shumë shkolla në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

III. Organizimi i Garave

Neni 8

Garat mund të organizohen çdo vit shkollor.

Garat sipas rregullave realizohen gjatë muajve tetor, nëntor dhe dhjetor..

Neni 9

Organizimi dhe realizimi i garave zhvillohet në dy faza:

- në nivel shkolle dhe
- në nivel shtetëror.

Neni 10

Organizimi dhe realizimi i garave në nivel të shkollës është nën kompetencat e shkollës së mesme.

Neni 11

Qendra cakton shkollën-nikoqire ku organizohet dhe realizohet gara në nivel shtetëror.

Neni 12

Drejtori i shkollës- nikoqire formon komision organizativ, i cili ka detyrë të përcaktojë kushtet materiale-teknike dhe hapësinore të nevojshme për organizimin dhe realizimin e garës në nivel shtetëror.

Neni 13

Kushtet materiale -teknike për realizimin e garës në nivel shtetëror sigurohen nga shkolla-nikoqire, në bashkëpunim me shkollat nga të cilat nxënësit marrin pjesë në garën në nivel shtetëror.

Neni 14

Kryetari dhe anëtarët e komisionit organizativ janë:

- kryetari i aktivitetit përkatës të mësimdhënësve – kryetar,
- mësimdhënës i lëndëve profesionale-teorike nga shkolla-nikoqire– anëtar, dhe
- mësimdhënës i arsimit praktik nga shkolla-pronare – anëtar.

Neni 15

Komisioni organizativ nga nenii 14 i kësaj rregulloreje përcakton grupe pune për mbledhjen e të dhënave, shqyrtimin dhe përgatitjen e rang-listave sipas kodeve dhe pikëve të fituara, si dhe për rangimin e nxënësve sipas rezultateve të arritura.

Neni 16

Aktivitetet për zgjedhjen e nxënësit më të mirë në sektor/kualifikim arsimor realizohen nëse në nivel shtetëror ka të paktën pesë pjesëmarrës nga i njëjti kualifikim, nga të paktën dy shkolla.

Neni 17

Ministri i Arsimit dhe Shkencës emëron komisionin qendror, në përbërje:

- drejtori i shkollës-nikoqire – kryetar,
- përfaqësues i Ministrisë – anëtar,
- këshilltar për fushën përkatëse nga Qendra – anëtar,
- përfaqësues i odës përkatëse – anëtar, dhe
- përfaqësues i fakultetit përkatës – anëtar.

Neni 18

Komisioni qendror:

- u dorëzon nxënësve testet dhe detyrat praktike /ushtrimet ,
- shënon fillimin e garës,
- deshifron, përpunon dhe nxjerr në pah rezultatet e pjesës praktike dhe teorike,
- vendos sipas ankesave dhe
- siguron rregullshmërinë e garës.

Neni 19

Në garat për zgjedhjen e nxënësit më të mirë në nivel shtetëror, Qendra:

- përgatit testet me çelësin e përgjigjeve,
- miraton detyrat praktike /ushtrimet me kriteret e pikëzimit sipas propozimit të shkollës-nikoqire, dhe
- përcakton kohëzgjatjen optimale të garës.

Neni 20

Kohëzgjatja e garës është maksimumi 150 minuta, prej të cilave 60 minuta janë për test dhe 90 minuta për punën /ushtimet praktike ose detyrën.

Neni 21

Gjatë garës, nxënësi lejohet të largohet nga hapsira vetëm një herë, jo më shumë se pesë minuta, me miratimin e testuesit. Përndryshe, pjesëmarrja e tij konsiderohet e përfunduar.

IV. Vlerësimi dhe rezultatet

Neni 22

Nxënësi më i mirë në sektor zgjidhet ai që ka fituar numrin më të madh të pikëve nga të gjithë nxënësit brenda sektorit.

Nëse më shumë nxënës arrijnë të njëjtin numër pikësh, për nxënës më të mirë shpallet ai që ka përfunduar garën në kohë më të shkurtër.

Neni 23

Numri maksimal i pikëve të fituara është 80, gjegjësishtë deri në 30 pikë për pjesën teorike dhe deri në 50 pikë për pjesën praktike.

Neni 24

Rang-lista preleminare me rezultatet publikohet në tabelën e shpalljeve të shkollënikoqire të njëjtën ditë kur përfundon gara.

Pjesëmarrësit kanë të drejtë të bëjnë ankesë te komisioni qendror, jo më vonë se 30 minuta pas publikimit të rezultateve.

Komisioni qendror shqyrton ankesat dhe publikon rezultatet përfundimtare jo më vonë se 60 minuta pas dorëzimit të ankesës.

V. Njoftim

Neni 25

Qendra dorëzon raport për rezultatet e garës në nivel shtetëror për të gjitha sektorët dhe kualifikimet arsimore te Ministria e Arsimit dhe Shkencës.

Raporti duhet të përmbajë të dhëna për: emrin e sektorit, numrin e përgjithshëm të pjesëmarrësve, numrin e pjesëmarrësve sipas kualifikimit, rezultatet e arritura dhe emrat e nxënësve të shpërblyer.

VI. Dispozita përfundimtare

Neni 26

Kjo rregullore hyn në fuqi të nesërmen pas sjellës së saj.

Nr. 18-14149/1
Data 07.11.2025
Shkup

Министерка за образование и наука,
проф. д-р Весна Јаневска с.р.